

PËRFSHIRJA DHE FUQIZIMI I GRAVE TË DIASPORËS

Prioritete dhe Mundësi

REKOMANDIME

Për të siguruar një zbatim efektiv të këtyre politikave, rekomandohet që:

- ● ● Të krijohen bashkëpunime të strukturuar mes diasporës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të rajonit.

- ● ● Të sigurohen fonde për projekte të dedikuara për gratë në diasporë (përmes partneriteteve me Organizata Jo-Fitimprurëse (OJQ), Fonde nga Qeveritë Lokale dhe të Vendeve Pritëse, Donacione dhe Sponsorizime nga Sektori Privat, Rrjetëzim dhe Lobim.); dhe

- ● ● Të forcohet mekanizmi i monitorimit llogaridhënies nga ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës nga perspektiva gjinore.

Bashkëautore:

LIRI KUÇI dhe JEHONA JAHAJ

KONTEKSTI

Diaspora shqiptare përfaqëson një potencial të rëndësishëm për zhvillimin socio-ekonomik dhe kulturor të Shqipërisë dhe Kosovës. Megjithatë, sfidat e shumta si mungesa e rrjetëzimit, konfliktet ndërbreznore dhe pabarazitë gjinore kërkojnë ndërhyrje të posaçme dhe gjithëpërfshirëse.

Ky dokument vjen si rezultat i diskutimeve dhe hulumtimit me organizatën Germin dhe forumin virtual me gra nga diaspora, ku u identifikuan sfidat dhe mundësitë për fuqizimin e tyre. Ky proces shërbeu për të ndërtuar një kornizë analitike kritike që sfidon narrativat tradicionale mbi diasporën, duke i qendëruar gratë dhe përvojat e tyre në aspekte që lidhen me sfidat, përfaqësimin politik, mundësitë dhe zhvillimin.

SFIDAT DHE NDËRHYRJET

Në diskursin mbi diasporën shqiptare, shpesh anashkalohen përvojat gjinore dhe ndërthurjet strukturore që formësojnë jetën e grave në mërgim. Sipas diskutimeve të zhvilluara nga Germin, dhe artikujve të pakët rezultojnë se gratë shqiptare në diasporë përballen me një dinamikë komplekse që përfshin presionet për ruajtjen e identitetit kombëtar, ngacmimeve seksuale (Radonshiqi, 2021), përballimin e barrierave institucionale dhe kulturore në vendet pritëse dhe sfidat që burojnë nga normat patriarkale në komunitetet e tyre. Megjithatë, mungesa e studimeve të thelluara dhe të dhënave të përditësuara mbi përvojat dhe nevojat e tyre krijojnë një boshllëk të konsiderueshëm në hartimin e politikave dhe programeve efektive. Kjo mungesë jo vetëm që kufizon ndërhyrjet e duhura për adresimin e këtyre sfidave, por edhe përforcon

padukshmërinë e kontributeve dhe problemeve të tyre. Për këtë arsye, është thelbësore që institucionet akademike, organizatat joqeveritare dhe agjencitë qeveritare të angazhohen në hulumtime të thelluara dhe të mbledhin të dhëna të besueshme, për të krijuar politika të bazuara në prova që adresojnë në mënyrë strukturore sfidat dhe potencialin e grave në diasporë.

REFLEKTIVE DHE REKOMANDIME

Përmes ndërhyrjeve dhe rekomandimeve të mëposhtme, kjo qasje synon jo vetëm të identifikojë nevojat e grave, por edhe të nxisë një transformim strukturor që fuqizon pozicionin e tyre si aktore kryesore në diasporë dhe më gjerë.

Krijimi i një platforme të centralizuar që të mundësojë profesionistë/et dhe individët e diasporës të lidhen dhe të ndërveprojnë mes tyre. Kjo platformë duhet të jetë më shumë se një bazë të dhënash teknike; ajo duhet të ndërtohet mbi parimet e solidaritetit gjinor dhe fuqizimit kolektiv. Një seksion i dedikuar grave profesioniste dhe sipërmarrëse nuk duhet thjesht të përfshijë gratë, por të sfidojë strukturat hierarkike që shpesh i përjashtojnë ato. Platforma mund të shërbejë si një hapësirë ku gratë ndajnë përvoja dhe sfidojnë normat gjinore që kufizojnë potencialin e tyre, duke krijuar një rrjetëzim njohurish dhe mbështetjeje reciproke - siç u evidentua edhe në samitin e pestë të grave të diasporës ([Samiti i Grave së Diasporës, 2024](#)).

Konfliktet ndërbreznore brenda diasporës shpesh fshehin dimensione gjinore të tensioneve, ku gratë mbajnë barrën e transmetimit të kulturës dhe vlerave në një kontekst që shpesh nuk i njeh përpjekjet e tyre. Nismat e reja duhet të përfshijnë programe që fuqizojnë gratë si urë lidhëse midis brezave, duke u dhënë atyre mjete për të sfiduar stereotipet gjinore dhe për të promovuar një ndërveprim më të barabartë ndërmjet grupeve të ndryshme. Shembuj në këtë drejtim janë [TurkishWin & Women Alb World](#).

Siç rezulton nga ky proces hulumtimi dhe diskutimet e organizuara përmes organizatës Germin, shëndeti mendor i grave në diasporë shpesh ndikohet nga normat patriarkale, presionet për ruajtjen e "rolit tradicional" dhe izolimit në mjedise të reja, problematizim i cili përforcohet edhe nga Radonshiqi (2021). Adresimi i shëndetit mendor si një prioritet për diasporën, duke theksuar rëndësinë e kolektivitetit, përmes një rrjeti feminist të përbërë nga mjeke, psikologe dhe punonjëse sociale shqiptare mund të ndihmojë në krijimin e programeve të mbështetjes që ndërtohen mbi parimet e kujdesit të përbashkët dhe kolektivitetit. Ndërtimi i mekanizmave të sigurt që mund të shërbejnë si pikë kontakti për gratë që ndihen të mënjanuara nga strukturat mbështetëse tradicionale.

Trajnimet për gratë duhet të kalojnë përtej "integritit të tyre në sistemet ekzistuese," duke krijuar modele ekonomike që i sfidojnë rrënjësisht strukturat patriarkale dhe kapitaliste që prodhojnë dhe riprodhojnë pabarazi gjinore dhe ekonomike. Nuk mjafton që gratë të përshtaten brenda kornizave ekzistuese të ekonomisë, kur këto korniza shpesh funksionojnë duke përjashtuar dhe marginalizuar kontributet e tyre. Mbështetja për start-up-et që promovojnë ekonominë e kujdesit, drejtësinë sociale dhe praktikën ekologjike është thelbësore për të ndërtuar modele të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, ku gratë janë jo vetëm pjesëmarrëse, por edhe dizajnuese të ndryshimeve përmbytëse.

Në këtë kontekst, rrjetet e bizneseve të diasporës - të pranishme pothuajse në çdo shtet ku ka bashkatdhetarë/e - përfaqësojnë një potencial të madh, por edhe një shembull konkret të barrierave gjinore. Këto rrjete dominohen kryesisht nga burrat dhe përfshirja e grave shpesh mbetet në nivel retorik. Megjithatë, kapitali financiar dhe social që ato zotërojnë nuk mund të mbetet një burim i paprekshëm për gratë. Duhet të ushtrohet presion kritik dhe të kërkohet një rishpërndarje e qëllimshme e burimeve të këtyre rrjeteve drejt projekteve që fuqizojnë gratë, duke sfiduar kështu jo vetëm mungesën e përfaqësimit, por edhe vetë strukturën hierarkike të këtyre rrjeteve.

Nxitja e pavarësisë ekonomike të grave në diasporë nuk mund të reduktohet në skema të fragmen- tuara trajnimesh apo grantesh. Politikat dhe ndërhyrjet duhet të sfidojnë normat dhe praktikrat që i mbajnë gratë jashtë pozicioneve vendimmarrëse dhe sektorëve strategjikë të ekonomisë. Kjo kërkon jo vetëm krijimin e kushteve për një rikthim që promovon barazinë gjinore dhe diversitetin, por edhe një angazhim të vazhdueshëm për të transformuar vetë sistemet ekonomike që kanë normalizuar përjashtimin dhe pabarazinë.

Gjithashtu, për të siguruar mbarëvajtjen e këtyre hapave, ndërtimi i besimit është një proces thelbësor që duhet të përfshijë edhe burrat, jo si shpëtimtarë, por si aleatë të barabartë në luftën për drejtësi gjinore. Politikat duhet të krijojnë hapësira për dialog ku burrat sfidojnë privilegjet e tyre dhe kon- tribuojnë në ndërtimin e një strukture më të barabartë.

PRIORITETET STRATEGJIKE DHE POLITIKAT E PROPOZUARA

Krijimi i një platforme gjithëpërfshirëse për rrjetëzimin profesional të diasporës apo avancimin e atyre ekzistuese. & databazë të kategorizuar sipas profesioneve, duke lehtësuar këshillimin, punësimin, zh-villimin e karrierës dhe shkëmbimin e përvojave: promovimi i barazisë gjinore dhe krijimin e rrjeteve mbështetëse për gratë në fusha të ndryshme. Kjo mundson ndërtimin i rrjeteve të mentorimit mes grave dhe komunitetit në përgjithësi për solidaritet, fuqizim dhe pjesëmrrje aktive në jetën publike.

- Krijimi i një linje virtuale të sigurt / portal për këshillim psikologjik dhe social, të dedikuar për sfidat e grave dhe emigrantëve të tjerë në diasporë.
- Zhvillimi i shërbimeve të mbështetjes psikologjike dhe sociale për gratë në diasporë.
- Adresimi i konflikteve ndërbreznore për të ndërtuar komunitete të qëndrueshme- trajnime, pro- grame, aktivitete rekreative.
- Mbështetja për gratë në diasporë nëpërmjet trajnimeve dhe start-up-eve: Krijimi i rrjeteve për lidhje me donatorë dhe grante për zhvillimin e bizneseve të udhëhequra nga gratë.
- Organizimi i programeve edukuese për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore shqiptare.
- Organizimi i forumeve periodike të diskutimeve, si virtuale ashtu edhe fizike, për të diskutuar nevojat dhe sfidat e diasporës.
- Institucionet akademike, organizatat joqeveritare dhe agjencitë/programet qeveritare të angazho- hen dhe bashkëpunojnë në prodhimin e njohurive të qëndrueshme, të mirëinformuara dhe të ndjeshme ndaj dimensioneve gjinore mbi përvojat e grave në diasporë, duke sfiduar paradigmen patriarkale të politikëbërjes dhe duke mbështetur politika transformuese që adresojnë rrënjësisht pabarazitë strukturore dhe kulturore, të informuara nga praktikrat më të mira ndërkombëtare dhe zërat autentikë të vetë grave.

PËRFUNDIME

Fuqizimi i gruas në diasporën shqiptare kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të mirëstrukturuar. Për të arritur përfshirje dhe mbështetje të qëndrueshme për diasporën femërore shqiptare, është e nevo-jshme të theksohen zhvillimet e politikave që synojnë fuqizimin e lidhjeve profesionale, mbështetjen sociale dhe psikologjike, si dhe integrimin e diasporës në zhvillimet e shoqërive shqiptare në shtetet përkatëse. Këto masa duhet të shërbejnë si bazë për ndihmën dhe zhvillimin e komunitetit shqiptar jashtë vendit, duke ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mundësive të punësimit, si dhe forcimin e lidhjeve kulturore dhe identitare me vendin e origjinës.

Zbatimi i këtyre politikave do të kontribuojë në ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme, forcimin e lidhjeve kulturore dhe ekonomike, promovimin e barazisë gjinore si vlerë qendrore dhe fuqizimit të individidëve.

REFERENCA

1. [Albinfo. 2017. "Gratë e suksesshme shqiptare në diasporë." Albinfo.ch.](#)
2. [BusinessMag. 2024. "Samiti i Gruas së Diasporës." BusinessMag Albania.](#)
3. [INSTAT. 2020. Diaspora e Shqipërisë në Shifra. Instituti i Statistikave të Shqipërisë.](#)
4. [Kult Plus. 2020. "Gratë shqiptare në diasporë bashkohen në një ekspozitë, përçojnë traditat shqiptare." KultPlus.](#)
5. [Radonshiqi, Romina. 2021. "Sfidat e gruas shqiptare në jetën social-ekonomike." Albspirit.](#)
6. [Women Alb World. Accessed on December, 2024.](#)
7. [Yeonhee Pyo & Ki Han Kwon 2024 "Factors Affecting Diasporic Women's Quality of Life: A systemic review" National Library of Medicine](#)
8. [GIZ 2023 "Women in the Diaspora of Germany and Engagement for Sustainable Development in Countries of Origin"](#)
9. [Dushi, Mimoza 2015 "Influence of migration in women emancipation: case study from Kosovan Albanian diaspora"](#)



Kjo analizë u realizua me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Qendra për Promovimin Shoqërisë Civile (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA)

